



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 154, Datë 28.09.2017

**MBI
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2018 PËR ZYRËN E
KOORDINIMIT TË ANKANDEVE TË KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONIT NË EUROPËN JUG-LINDORE (SEE CAO)**

Në mbështetje të neneve 16, 30 dhe 65 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të nenit 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, datë 26 Shtator, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme; si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendim nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E) në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e ”draft– Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandëve Të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug-Lindore (SEE CAO) të përgatitur nga Drejtoritë Teknike.

Konstatoi se,

- Operatorët e Sistemit të Transmetimit të SEE dhe Zyra e Koordinuar e Ankandit në Evropën Juglindore (SEE CAO) kanë përgatitur një grup të ri rregullash për të zbatuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (referuar si HAR) në rajonin e Evropës Juglindore për procesin e ankandit për vitin 2018.
- Rregullorja është hartuar në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, datë 26 Shtator për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (*Forward Capacity Allocation – FIA*).
- ERE me Vendimin nr. 125, datë 16.08.2017, filloi procedurat për miratimin e “Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO)”.
- ERE me shkresën Nr. 100/34 Prot., datë 17.08.2017, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 18 Gusht 2017. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.

- Me shkresën nr. 561 Prot., datë 21.08.2017, ERE dërgoi “Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO)”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, Autoriteti i Konkurrencës, Shoqatës AAES, si dhe për dijeni shoqërisë OST sh.a.
- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se nuk ka pasur asnjë koment nga palët e sipërcituara.
- Ankandet eksplicite të koordinuara Vjetore, Mujore dhe Ditore të zhvilluara për vitin 2017 janë kryer sipas Rregullave të Ankandit të SEE CAO v.1.4, të miratuara nga të gjitha Autoritetet Rregullatore Kombëtare në vitin 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO) bashkëlidhur.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI